



**Tetor 2022**

**Çfarë ka të re në SHUKALB!**



**Elisabeta Poçi, Drejtore Ekzekutive e SHUKALB emërohet Anëtare e Bordit të Drejtorëve të Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (IWA)**



**Trajnimet dhe programet e ardhshme të zhvillimit të kapaciteteve**

[Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Ujërave të Ndotura për Menaxherët dhe Inxhinierët, Trajnimi mbi "Teknologjitë"](#)  
12-14 Tetor 2022

[Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Ujërave të Ndotura për Menaxherët dhe Inxhinierët, Trajnimi "Menaxhimi i Projekteve Infrastrukturore"](#)  
9-10 Nëntor 2022

[Siguria në Punë për Profesionistët e Ujërave të Ndotura](#)  
23-24 Nëntor 2022, Tirana

SHUKALB është krenar të sjellë në vëmendjen e lexuesve të Burimit se Drejtorja jonë Ekzekutive, Elisabeta Poçi, është emëruar si anëtare e Bordit të Drejtorëve të Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (IWA). Emërimi u miratua gjatë Mbledhjes së Asamblesë Drejtuese të IWA në Kopenhagë, Danimarkë, që u mbajt përpara Kongresit dhe Ekspozitës Botërore të Ujit të IWA-së organizuar më 11-15 shtator 2022. Znj. Poçi do të shërbejë në Bord për periudhën 2022-2024. [lexo më shumë](#)

**SHUKALB nis programin e RCDN-së të zhvillimit të kapaciteteve me temë "Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Ujërave të Ndotura për Menaxherët dhe Inxhinierët"**

**Konferencat e Ardhshme Ndërkombëtare**



## Konferenca e 17-të e EWA Hibride e Brukselit

Vivaqua, Bruksel  
8 Nëntor 2022

## Samiti Dixhital i Ujit

Bilbao, Spanjë  
29 Nëntor – 2 Dhjetor 2022

Më 22 dhe 23 shtator 2022, në Tiranë, SHUKALB zhvilloi me sukses trajnimin 2-ditor me temë “Aspekte Rregullatore dhe të Financimit për Ujërat e Ndotur”, në kuadër të Programit të Zhvillimit të Kapaciteteve “Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Trajtimit të Ujërave të Ndotur për Menaxherët dhe Inxhinierët”, i cili pilotohet për herë të parë në kuadër të Projektit “Rrjeti Rajonal për Zhvillimin e Kapaciteteve për Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve (RCDN)”.

Në trajnim morën pjesë përfaqësues nga Shoqëritë UK Vlorë, Shkodër, Lezhë, Kamëz, Fier dhe Himarë, si dhe Bashkitë Vlorë dhe Lezhë. [lexo më shumë](#)

## **Regjistrimi në Konferencën dhe Ekspozitën e 10-të të Përbashkët Ballkanike është ende i hapur!**

### **UJËRAT NËNTOKËSORË** TË BËJMË TË PADUKSHMEN TË DUKSHME

KONFERENCA DHE EKSPOZITA  
E PËRBASHKËT BALLKANIKE  
8-10 NËNTOR 2022  
PRISHTINË, KOSOVË

**10** VJET  
Konferenca dhe Ekspozita  
e Përbashkët Ballkanike  
2013-2022

**SHUKOS**

**SHUKALB**  
SHOQATA UJËSJELLËS  
KANALIZIME E SHQIPËRISË



## **Bashkohuni me Ne!**



**Na tregoni se cfarë  
mendoni!**



Ka mbetur vetëm një muaj nga Konferenca dhe Ekspozita e 10-të e Përbashkët Ballkanike, **Ujërat nëntokësorë – Të bëjmë të padukshmen të dukshme**, që do të mbahet në **Prishtinë, Kosovë, më 8-10 nëntor 2022, në Hotel Emerald**.

Regjistrimi në Konferencë është ende i hapur dhe mund të bëhet përmes dy mënyrave:

## **Rreth SHUKALB**


Shoqata Ujësjellës  
Kanalizime e Shqipërisë  
(SHUKALB), e themeluar në

- Duke u regjistruar online nëpërmjet këtij linku: <https://crm.shukalb.al/civicrm/event/info/?reset=1&id=70>
- Duke plotësuar [Formularin e Regjistrimit](#) dhe duke e kthyer atë me email në: [info@BalkansJointConference.org](mailto:info@BalkansJointConference.org)

[lexo më shumë](#)

## Të tjera

### Ujërat e ndotura si një burim – Koha për të integruar Parimet e Ekonomisë Qarkulluese



Në një botë ku kërkesa për ujë është vazhdimisht në rritje dhe ku burimet e kufizuara ujore në dispozicion po bëhen gjithnjë e më të rrezikuara nga nxjerrja e tepërt, ndotja dhe ndryshimet klimatike, ujërat e ndotura paraqesin mundësi për rikuperimin e suksesshëm të burimeve duke kontribuar në ekonominë qarkulluese dhe duke

mundësuar një zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë. . Raporti i publikuar nga Banka Evropiane e Investimeve në maj 2022, ofron një pasqyrë të detajuar të këtyre mundësive.

Raportin mund ta shikoni në këtë [link](#).

[lexo më shumë](#)

### Duke iu afruar përfundimit trajnimi për Menaxhimin e Shoqërive Ujës-jellës Kanalizime përmbyll modulën e shtatë të trajnimit



vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.

Klasa e parë e trajnimit për Menaxhimin e Shoqërive Ujësjiellës Kanalizime po i afrohet diplomimit, pasi ka përfunduar javën bazë të trajnimit të modulit 7 dhe ka nisur drejt modulit përfundimtar 8, i cili do të mbahet si kurs i drejtpërdrejtë në nëntor në Vjenë.

Trajnimi për Menaxhimin e Shoqërive Ujësjiellës Kanalizime është programi kryesor i D-LeaP, Partneriteti i Danubit. Duke bashkëpunuar me shoqëritë kryesore në Evropën Qendrore dhe Lindore, Universitetin e Sofjes dhe Bankën Botërore si një partner institucional, ky program synon të "pajisë" menaxherët aktualë dhe të ardhshëm të sektorit të ujit me mjete dhe teknika për të mbështetur vendimmarrjen e tyre dhe për të promovuar praktikën më të mirë për të siguruar shërbime ujësjiellës kanalizime të besueshme, të sigurta, gjithëpërfshirëse, transparente dhe të përgjegjshme të ofruara nga shoqëri efikase, të qëndrueshme, novatore dhe ekonomike të shëndosha. [lexo më shumë](#)

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

**Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë,**

Rruga "Pjetër Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqipëri

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: [info@shukalb.al](mailto:info@shukalb.al), Web: [www.shukalb.al](http://www.shukalb.al)

Çregjistrohu